



Breaking News: Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër/Arrestohet 1 shtetas

⏏ ⏪ ⏩



LajmetOperacionet

31/01/2025

Durrës – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Debt”

Durrës/Finalizohet operacioni policor i koduar “Debt”, për kapjen e një shtetasi të shpallur në kërkim.

2 javë më parë, kanosi një shtetasve dhe mori automjetin, sepse pretendonte se i kishte borxh një shumë parash, kapet dhe ndalohet 37-vjeçari.

Në momentin e ndalimit, në banesën e këtij shtetasi u gjetën një sasi Cannabisi e ndarë në doza gati për shitje, dhe një sasi municioni luftarak.

Sekuestrohen dozat e lëndës narkotike, 1 peshore elektronike dhe municioni luftarak.

Në vijim të kontrolleve të bazuara te informacionet e siguruara nga intelijenca policore, me objektiv lokalizimin, kapjen dhe vënien në pranga të shtetasve të shpallur në kërkim, specialistët për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, finalizuan operacionin policor të koduar “Debt”.

Gjatë operacionit u vu në pranga shtetasi E. V., 37 vjeç, banues në Durrës, pasi dyshohet se më datë 17.01.2025, me anë të kanosjes dhe shtrëngimit, i ka marrë automjetin një shtetas, sepse pretendonte se ky i fundit i kishte borxh 1200 euro.

Më tej, nga kontrolli në banesën e 37-vjeçarit, u gjetën doza të lëndës narkotike Cannabis Sativa, të gatshme për shitje, sende nëpërmjet të cilave ndaheshin dozat dhe një sasi fishekësh kallashnikovi.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◄ Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Drejtues Madhor Ilir Proda, gjatë prezantimit të sondazhit të IDRA “Kënaqësia e publikut me punën e Policisë”, që mat perceptimin e qytetarëve për sigurinë publike

Tiranë/Plagosi me mjet prerës mbremjen e djeshme 46-vjeçarin G. K, gjatë një konflikti për motive të dobëta, arrestohet 42-vjeçari ►